

VENDIM
Nr. 11, datë 28.2.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 27.2.2024, mori në shqyrtim në seancë mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 8 (L) 2023, që u përket:

KËRKUESE: Ledina Mandija

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga avokatët e shtetit Drita Shkurti dhe Irma Qosja, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 32/1, datë 19.1.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i cenimit të së drejtës për një gjykim në një afat të arsyeshëm kohor në Gjykatën Administrative të Apelit, referuar vendimmarrjes së saj me vendimin nr. 5182, datë 7.12.2017, duke tejkaluar afatin e caktuar nga ligji.

Konstatimi i cenimit të së drejtës për një gjykim në një afat të arsyeshëm kohor në Gjykatën e Lartë për çështjen administrative regjistruar me nr. 31003-00565-00-2018.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 71/a, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësja Ledina Mandija, me urdhrin nr. 15, datë 6.4.2007, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, është komanduar në detyrën e Avokatit të Shtetit pranë Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit dhe më pas është emëruar përfundimisht në këtë detyrë, ndërsa në datën 5.6.2009, është emëruar në detyrën e Avokatit të Shtetit në Zyrën e përfaqësimit në Gjykatat e Huaja Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar pranë Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit.

2. Me urdhrin nr. 4, datë 6.1.2010, të Kryeministrit kërkuesja është emëruar në detyrën e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, ndërsa me urdhrin e tij nr. 156, datë 7.10.2013, është liruar nga kjo detyrë. Ajo është emëruar sërish si Avokate e Shtetit në Zyrën e Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar pranë Avokaturës së Përgjithshme me urdhrin e datës 18.11.2013, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.

3. Në vijim, me urdhrin e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, nr. 29, datë 10.2.2014, kërkuesja është emëruar Avokate e Shtetit në Zyrën e Këshillimit dhe të Koordinimit Ndërminstoror pranë Avokaturës së Përgjithshme, duke u ngarkuar ajo të ndjekë edhe proceset gjyqësore të ardhura nga gjykatat administrative të rretheve në Gjykatën Administrative të Apelit, kurse me urdhrin e tij nr. 105, datë 26.5.2014, ajo është komanduar të përfaqësojë në Gjykatën e Apelit Tiranë çështjet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë. Ndërkohë, me urdhrin e tij nr. 138, datë 3.9.2014, kërkuesja është shkarkuar nga detyra e Avokatit të Shtetit pranë Zyrës së Këshillimit dhe Koordinimit Ndërminstoror.

4. Në datën 17.10.2014, kërkuesja i është drejtuar gjykatës me padi me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit nr. 138, datë 3.9.2014, rikthimin në detyrën e Avokatit të Shtetit pranë Zyrës së Përfaqësimit në Gjykatat e Huaja Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar, në nivel qendror, si dhe shpërblimin për pagat e papaguara që nga momenti i lëshimit të aktit deri në ekzekutimin e vendimit. Po kështu, ajo ka kërkuar edhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrave nr. 29, datë 10.2.2014 dhe nr. 105, datë 26.5.2014, dhe shpërblimin e dëmit moral të shkaktuar nga veprimet e Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, detyrimin për pagimin e 2 pagave mujore të funksionit dhe interesat nga momenti i largimit nga funksioni i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit dhe detyrimin për pagimin e pagës nga data 7 tetor deri më 8 nëntor 2013, si dhe çdo pagesë tjetër për ditët e papaguara dhe interesat e akumuluar. Si palë të paditur në gjykim kërkuesja ka thirrur Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit dhe procesi gjyqësor ka vijuar për këtë ndërgjyqësi.

5. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 7785, datë 26.12.2014, ka vendosur të pranojë pjesërisht kërkesëpadinë, duke detyruar palën e paditur, Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit të dëmshpërblejë paditësen Ledina Mandija me 12 muaj paga për shkak të zgjidhjes së kontratës së shërbimit publik pa shkak të ligjshëm, ndërkohë ka rrëzuar kërkesëpadinë për pjesën tjetër. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 5182, datë 7.12.2017, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 7785, datë 26.12.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me arsyetimin se në gjykimin në shkallë të parë janë lejuar shkelje të rënda procedurale që passjellin pavlefshmërinë e tij, ndërsa gjykimi i çështjes është zhvilluar për një ndërgjyqësi të paplotë. Sipas asaj gjykate, gjykata e shkallës së parë ka gjykuar padinë pa kërkuar nga paditësja (kërkuesja) rregullimin e ndërgjyqësisë nëpërmjet thirrjes në gjykim të personit juridik publik, Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, të cilit mund t'i kundrejtoheshin kërkimet për pagesë të detyrimeve dhe dëmshpërblimeve si pasoje e veprimeve të paligjshme të drejtuesit të tij, duke lejuar dhënien e vendimit kundër një pale, legjitimiteti pasiv i së cilës nuk është ndërtuar në përputhje me rregullat procedurale. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

7. Mbi bazën e rekursit të kërkueses çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 12.3.2018. Sipas të dhënave të faqes zyrtare të kësaj gjykate, çështja e kërkueses është planifikuar për t'u shqyrtuar në dhomën e këshillimit të datës 1.12.2022 dhe në datën 16.11.2022 është publikuar njoftimi në rubrikën përkatëse. Po sipas informacionit të publikuar në datën 1.12.2022, në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, çështja e kërkueses është shtyrë për një datë tjetër dhe ajo rezulton të jetë shqyrtuar në datën 22.12.2022 nga Kolegji Administrativ, i cili, me vendimin nr. 00-2022-4058, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se nuk përmbante shkaqe nga ato

të parashikuara në nenin 58, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

8. Pas publikimit të njoftimit për datën e shqyrtimit të rekursit, kërkuësja, në datën 25.11.2022, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së të drejtës për proces të rregullt nga Gjykata Administrative e Apelit dhe vetë Gjykata e Lartë, për shkak të tejzgjatjes së procedurës së gjyimit përpara tyre dhe, në veçanti për Gjykatën e Lartë, në kushtet kur bëhej fjalë për një çështje të kthyer për rigjykim dhe, për më tepër, për një mosmarrëveshje pune. Për këtë kërkesë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 32/1, datë 19.1.2023, ka vendosur pushimin e shqyrtimit të saj, në zbatim të pikës 3, të nenit 399/7 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), me arsyetimin se çështja gjyqësore e kërkuësës kishte përfunduar në Gjykatën e Lartë me vendimin e datës 22.12.2022, ndaj, për rrjedhojë, kërkesa ka mbetur pa objekt. Ky vendim i është komunikuar kërkuësës me dëftesën e komunikimit të datës 6.2.2023.

9. Me kërkesën e datës 19.5.2023, nëpërmjet shërbimit postar, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 2.6.2023.

10. Me vendimin e datës 15.9.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit, me vendimin e datës 21.9.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor, duke parashtruar:

11.1 Kërkesa për konstatimin e cenimit të kohëzgjatjes së paarsyeshme dhe përshejtimin e procesit gjyqësor është shqyrtuar tej afatit ligjor 45-ditor të përcaktuar në nenin 399/7, pika 2, të KPC-së. Relatori i çështjes, edhe pse sipas ligjit duhej të shprehej brenda 15 ditëve për kërkesën, mendimin e tij e ka shprehur pasi ishte dhënë vendimi i Kolegjit Administrativ për çështjen e themelit. Gjykata e Lartë nuk është shprehur për kërkimin e konstatimit të cenimit të procesit në gjykatën e apelit edhe pse ishte objekt i asaj kërkesë.

11.2 Në lidhje me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor të themelit të çështjes, gjykata e shkallës së parë e ka shqyrtuar çështjen brenda afateve ligjore, kurse në gjykatën e apelit procesi ka zgjatur 3 vjet dhe në përfundim të tij është vendosur kthimi i çështjes për rishqyrtim. Lidhur me afatet e gjyimit, neni 48, i ligjit nr. 49/2012, parashikon se gjykata e apelit e shqyrton ankimin brenda 30 ditëve, për rrjedhojë gjykimi i çështjes së kërkuësës në gjykatën e apelit është tejzgjatur.

11.3 Në Gjykatën e Lartë, për rekursin e kërkuësës, çështja është regjistruar në mars 2018 dhe vetëm në nëntor 2022 është planifikuar shqyrtimi i saj në dhomën e këshillimit, pavarësisht se ajo bënte pjesë në kategorinë e çështjeve që shqyrtohen me procedurë të përshejtuar, duke qenë përpara rastit kur gjykata e apelit kishte vendosur kthimin e saj për rigjykim, si dhe kur ajo ka të bëjë me një konflikt pune. Për rrjedhojë, është kapërcyer çdo afat kohor referuar nenit 399/2 të KPC-së.

11.4 Çështja nuk ka karakter kompleks, ndërkohë që, referuar sjelljes së autoriteteve, është e dukshme që të dyja gjykatat janë në vonesë. Mekanizmi i ri që ofron KPC-ja është joefektiv, pasi nuk jep mundësinë e konstatimit të shkeljeve në rastet e tejzgjatjes së procedurave dhe mundësinë e shpërblimit të dëmit për këtë shkak.

11.5 Të dyja gjykatat dukshëm janë në shkelje të ligjit, për sa kohë kanë vonuar gjykimin e çështjes dhe kanë dështuar në përdorimin e mjeteve procedurale për përshejtimin e zgjidhjes së themelit. Çështja është e një lloji të caktuar ku, ndër të tjera, ka edhe diskriminim dhe shkelje të së drejtës për jetë familjare të mbrojtur nga neni 8 i KEDNJ-së ku përfshihen edhe marrëdhëniet e punës.

12. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

12.1 Duke analizuar kriteret për përlogaritjen e afatit të arsyeshëm, në lidhje me periudhën që duhet marrë në konsideratë, rezulton se çështja është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 12.3.2018. Kjo gjykatë, në vitin 2019, për shkak të procesit të vetingut të gjyqtarëve, doli jashtë funksionit dhe pas rifillimit të saj, bazuar në urdhrin nr. 164, datë 2.9.2021 të zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë, çështja është rihedhur në short duke iu caktuar gjyqtarit A.V. Nga kjo datë dhe deri në marrjen e vendimit, në datën 22.12.2022, ka kaluar pak më shumë se 1 vit, për rrjedhojë nuk është kaluar afati 2-vjeçar i parashikuar në nenin 399/2, pika 2, të KPC-së. Ligjvënësi me ndryshimet në KPC, konkretisht në nenin 399/2, pika 3, janë parashikuar shprehimisht rrethanat e pamundësisë objektive për llogaritjen e afateve në kohëzgjatjen e gjykimit si shkak për shkarkimin nga përgjegjësia për kalimin e afatit të parashikuar në nenin 399/2, pika 2, të KPC-së.

12.2 Tejzgjatja e procedurave gjyqësore, në rastin konkret, nuk paraqet shkallë të konsiderueshme rreziku për interesin e kërkuësës në kushtet kur gjykata e apelit ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim. Kërkuësja, për më tepër, nuk ka arritur të provojë faktin se nuk është në marrëdhënie pune. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve duhet mbajtur në konsideratë ngarkesa totale individuale e gjyqtarit relator dhe ngarkesa e tij në raport me gjyqtarët e tjerë. Kjo çështje i është caktuar gjyqtarit relator sipas shortit të datës 2.9.2021, për rrjedhojë nuk rezulton që ai të ketë krijuar vonesa në shqyrtimin e saj. Sipas informacionit të marrë nga Gjykata e Lartë, për sa i përket ngarkesës së gjyqtarit relator përgjatë periudhës korrik 2021–2022 llogariten rreth 9582 çështje të mbartura, përveç çështjeve të tjera të regjistruara gjatë kësaj periudhe. Mosveprimi i Gjykatës së Lartë nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime në kundërshtim me ligjin nga ana e gjyqtarit. Shqyrtimi i çështjeve nga gjykata, në respektim të parimit të prioritetit, në kohë, realizohet duke marrë në konsideratë çështjen më të hershme të regjistruar. Në lidhje me pretendimin e kërkuësës për gjykimin e çështjes konkrete me procedurë të përshpejtuar, nuk rezulton që ajo të ketë paraqitur kërkesë me shkrim për përshpejtimin e gjykimit.

12.3 Pretendimi për konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për përshpejtimin e gjykimit, të cilin kërkuësja e ka lidhur me mosshqyrtimin e kërkesës nga Gjykata e Lartë brenda afatit 45-ditor dhe se relatori duhej të shprehej brenda 15 ditëve, nuk është ngritur në nivel kushtetues. Kolegji Penal, me të drejtë, ka konkluduar se çështja ka mbetur pa objekt, duke qenë se për të është marrë vendim në datën 22.12.2022. Mjeti procedural i përdorur nga kërkuësja e ka arritur qëllimin e tij përshpejtues, për sa kohë që Gjykata e Lartë e ka përshpejtuar gjykimin e çështjes së kërkuësës, duke u dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë substanciale për cenimin e interesave të ligjshëm të ngritura në rekurs.

12.4 Pretendimi për cenimin e *parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit* është i pabazuar, për sa kohë që kërkuësja nuk ofron asnjë argument mbi mundësinë e diskriminimit. Nuk rezulton asnjë procedurë gjyqësore ose administrative që kërkuësja të jetë diskriminuar. Ajo nuk ka paraqitur kërkesë ankimore pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe as nuk rezulton që t'u jetë drejtuar organeve gjyqësore në lidhje me këtë pretendim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësës

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë

themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

15. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuësi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Nga ana tjetër, duhet theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike *efektive*, në kuptimin e shterimit të atyre mjeteve që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata ka pohuar se kërkuësi duhet t’i ketë përdorur të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Duke qenë se mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (*shih vendimin nr. 31 datë 4.10.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). E thënë ndryshe, ky rregull nënkupton që kërkuësi duhet të shterojë vetëm mjetet juridike “efektive”, përpara se t’i drejtohet Gjykatës, në kuptimin e shterimit vetëm të atyre mjeteve juridike, të afta për të rivendosur të drejtën, që pretendohet se është shkelur. Në të kundërt, vetë Gjykata rrezikon të mos konsiderohet si një “mjet efektiv”. Mjeti juridik përshpejtues është “efektiv” nëse përshpejton vendimarrjen e gjykatës në fjalë, ndërkohë që, bazuar në parimin e subsidiaritetit, i cili bën të mundur shmangien që individët t’i drejtohen sistematikisht kësaj gjykate për pretendime që do të ishin shqyrtuar më mirë brenda sistemit juridik kombëtar, aty ku është parashikuar një mjet juridik i brendshëm, ajo vlerëson nëse mjeti është ose jo efektiv (*shih vendimin nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) rregulli i *shterimit të mjeteve juridike efektive* zbatohet me një shkallë fleksibiliteti dhe pa formalizëm të tepruar, duke pasur parasysh mbrojtjen e të drejtave themelore dhe se do të ishte tepër formaliste t’u kërkohej kërkuësve që të përdorin një mjet juridik të cilin as gjykata më e lartë e vendit nuk i ka detyruar ta përdornin (*shih D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke [DhM], 2007, §§ 116–18*). Nëse ka më shumë se një mjet juridik potencialisht efektiv, aplikantit i kërkohej të ketë përdorur vetëm njërin prej tyre (*shih Karakó kundër Hungarisë, 2009, § 14*), duke mos iu kërkuar domosdoshmërisht të përdorë edhe të tjera që në thelb kanë të njëjtin qëllim (*shih Jasinskis kundër Letonisë, 2010, §§ 50 dhe 53–54*). Neni 6, paragrafi 1, i KEDNJ-së nuk kërkon që kërkuësit të bashkëpunojnë në mënyrë aktive me autoritetet gjyqësore dhe ata nuk mund të fajësohen për përdorimin e plotë të mjeteve juridike të disponueshme sipas ligjit të brendshëm (*shih Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë, 23 prill 1987, § 68; Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë [Dh.M.], datë 25 qershor 2019, § 211*). Kërkuësit i kërkohej vetëm që të tregojë kujdesin e duhur në kryerjen e hapave proceduralë që lidhen me të, që të mos përdorë taktika vonuese dhe të përfitojë nga qëllimi i ofruar nga ligji i brendshëm për shkurtimin e procedurave (*shih Unión Alimentaria Sanders S.A. kundër Spanjës, datë 7 korrik 1989, § 35*).

18. Po sipas GJEDNJ-së, vlerësimi nëse mjetet juridike të brendshme janë shteruar zakonisht kryhet duke iu referuar gjendjes së procedurave në datën në të cilën kërkesa është depozituar para saj. Megjithatë, ky rregull u nënshtrohet përjashtimeve pas krijimit të mjeteve të reja juridike (*shih*

Ëmër kundër Turqisë (dek.), 2006, §§ 72 e në vijim). Gjykata është larguar nga ky rregull në veçanti në çështjet që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e procedurave (*shih Beshiri dhe të tjerët kundër Shqipërisë (dek.)*, § 177 dhe §§ 216–218; *Olkhovik dhe të tjerët kundër Rusisë (dek.)*, 2022, §§ 34–41). Ajo ka theksuar edhe se merr parasysh efektivitetin dhe aksesueshmërinë e mjeteve juridike që mbivendosen (*shih Demopoulos dhe të tjerët kundër Turqisë (vendim) [GC]*, 2010, § 88).

19. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se në kërkesën e saj, në drejtim të tejzgjatjes së procedurave, kërkuësja ka ngritur pretendime qoftë në drejtim të procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë në lidhje me shqyrtimin e rekursit të paraqitur nga ajo, ashtu edhe në drejtim të procesit të zhvilluar në gjykatën e apelit. Kërkuësja ka pretenduar, gjithashtu, edhe mungesën e efektivitetit të mjeteve të reja juridike të parashikuara nga KPC-ja, me argumentin se ky mekanizëm nuk jep mundësinë e konstatimit të shkeljeve në rastet e tejzgjatjes së procedurave dhe atë të shpërblimit të dëmit për këtë shkak.

20. Gjykata konstaton se deri në hyrjen në fuqi të mjeteve të reja juridike të parashikuara nga KPC-ja, ajo ka legjitimuar individin për paraqitjen e kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, edhe kur për to nuk ishte dhënë një vendim përfundimtar, në kuptim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për sa kohë legjislacioni nuk parashikonte mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimet nr. 26, datë 27.3.2017; nr. 69, datë 17.11.2015; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, gjatë kohës që çështja e kërkuësës ishte për shqyrtim në gjykatën e apelit, edhe pse Gjykata kishte juridiksion për shqyrtimin e kërkesave për kohëzgjatjen e afatit të arsyeshëm, ajo nuk ka paraqitur kërkesë të tillë për konstatimin e kohëzgjatjes së paarsyeshme të gjykimit të çështjes së saj. Po gjatë kësaj periudhe, konkretisht në datën 30.3.2017, u miratuan ndryshimet e reja procedurale të KPC-së të cilat hynë në fuqi në datën 5.11.2017, pra rreth një muaj përpara se gjykata e apelit të jepte vendimin e saj për çështjen e kërkuësës.

21. Këto dispozita të reja procedurale, nenet 399/1 e vijues të KPC-së, kanë përcaktuar se çfarë do të konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), çfarë do të konsiderohet shpërblim i drejtë (*neni 399/3*), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (*nenet 399/4 dhe 399/6*), rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*) etj. Sipas nenit 399/3 të KPC-së, shpërblim i drejtë konsiderohet njohja e shkeljes, masat e marra për përshpejtimin e procedurave dhe/ose shpërblimi i dëmit, i përcaktuar në vlerë monetare në nenin 399/10 të këtij kodi. Në lidhje me efektivitetin e këtyre mjeteve juridike, Gjykata ka vlerësuar se, në parim, legjislacioni parashikon tashmë një mjet juridik ankimi efektiv, i cili garanton si përshpejtimin e procesit gjyqësor, ashtu edhe dëmshpërblimin, pra ofron një rezultat konkret në drejtim të rivendosjes të së drejtës së shkelur për proces gjyqësor brenda afateve të arsyeshme ligjore (*shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 37, datë 15.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021; nr. 80, datë 18.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në lidhje me këto mjete juridike, Gjykata thekson se, si rregull, për sa i përket cenimit të së drejtës për proces të rregullt për shkak të tejzgjatjes ose zvarritjes së procedurave, mjeti efektiv për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave i përket gjyqësorit të zakonshëm, ndërkohë që Gjykata investohet vetëm për riparimin e shkeljeve të kryera nga ato gjykata, në rast se ato nuk janë në gjendje të korrigjojnë dhe riparojnë shkeljen e së drejtës për proces të rregullt, pra në rast se provohet se mjeti juridik nuk ka qenë efektiv. KPC-ja ka njohur dy instrumente në këtë drejtim, që janë kërkesa për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procesit dhe, më pas, kërkimi i dëmshpërblimit që është kompetencë e gjykatës së shkallës së parë. Në këtë kuptim, edhe pse Gjykata, pavarësisht miratimit nga ligjvënësi të mjeteve të reja juridike për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ende investohet për shqyrtimin e këtyre kërkesave, vendimi i saj nuk konsiderohet si instrumenti normal që i paraprin kërkesës për dëmshpërblim.

23. Duke iu rikthyer rastit konkret, në vlerësimin e Gjykatës kërkuësja, gjatë kohës që çështja e saj ndodhej në gjykatën e apelit, edhe pse kishte në dispozicion dy mjete juridike, pra ankimin kushtetues dhe kërkesën sipas neneve 399/1 e vijues të KPC-së, ajo nuk rezulton të ketë treguar

kujdesin e duhur për ndërmarrjen e atyre hapave proceduralë që i njihen legjislativori në fuqi për të siguruar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit ose edhe përshpejtimin e procedurave. Paraqitja e një ankimi kushtetues në Gjykatë, pavarësisht natyrës deklarative të vendimit që konstatonte cenimin, edhe pse mund të mos kishte pasoja në drejtim të përshpejtimin të gjykimit të zakonshëm, do të kishte pasigjellë për kërkuuesin lindjen e së drejtës për të kërkuar shpërblimin e dëmit në gjykatat e zakonshme për shkak të vonësës qoftë në bazë të dispozitave materiale civile, qoftë në bazë të dispozitave të reja procedurale që hynë në fuqi në atë kohë.

24. Gjykata vëren se kërkesën për konstatimin e shkeljes së të drejtës për proces të rregullt për shkak të tejzgjatjes së procedurave të gjykimit dhe për përshpejtimin e tyre, kërkuësja e ka paraqitur vetëm në datën 25.11.2022, pra pasi ishte publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë njoftimi për shqyrtimin e çështjes së saj në dhomën e këshillimit, njoftim për të cilin, në kërkesën e saj, ajo pranon se ka marrë dijeni. Për rrjedhojë, kjo kërkesë qartazi ka qenë formale dhe as vetë kërkuësja nuk duket se ka pasur ndonjë pritshmëri në drejtim të efektivitetit të saj lidhur me përshpejtimin e procesit, zhvillimi i të cilit tashmë ishte planifikuar duke u caktuar edhe data e shqyrtimit të rekursit. Për pasojë, paraqitja formalisht e një kërkesë në Gjykatën e Lartë nuk mund të konsiderohet e mjaftueshme në kuptim të shterimit të mjeteve juridike përpara vënies në lëvizje të gjykimit kushtetues.

25. Gjykata ka theksuar se neni 13 i KEDNJ-së i lejon një shteti të zgjedhë midis një mjeti “parandalues ose përshpejtues”, i projektuar për të përshpejtuar procedurat në mënyrë që të parandalojë që ato të tejzgjasin dhe një mjeti “riparues, kompensues ose monetar” që parashikon korrigjimin *ex post facto* për vonesat që kanë ndodhur tashmë, qoftë nëse procedura është ende në shqyrtim apo nuk ka përfunduar ende. Ligjvënësi ka bërë një parashikim për një zgjidhje përshpejtuese/parandaluese dhe kompensuese në nenet 399/1 e vijues të KPC-së, efikasiteti i përgjithshëm i së cilës, në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së, është vlerësuar edhe nga GJEDNJ-ja në *çështjen Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, duke arritur në përfundimin se zgjidhja për përshpejtimin e procedurave dhe ofrimin e kompensimit është efikase, pasi mund të parandalojë vijimësinë e shkeljes së pretenduar të së drejtës së individit që çështja e tij të dëgjohet pa vonesa të tepërta, si dhe të garantojë korrigjimin e duhur për shkeljet që kanë ndodhur (*shih vendimin nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Duke iu referuar dispozitave procedurale në fuqi, nenet 399/1 e vijues të KPC-së, Gjykata çmon se këto mjete synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese të individit për zhvillimin e procedurave/gjykimit brenda një afati të arsyeshëm duke siguruar: i) parandalimin e shkeljes, në kuptimin që në një çështje konkrete, e cila është duke zgjatur në kohë, të urdhërohet përshpejtimi i procedurave në mënyrë që individit të mos i cenohet e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm; ii) riparimin e shkeljes, nëpërmjet përfundimit të procedurave sa më shpejt të jetë e mundur dhe, eventualisht, caktimit të një dëmshpërblimi. Këto mjete juridike janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën në mënyrë subsidiare, pra në atë mënyrë që, në rast se mjetet parandaluese nuk kanë qenë efektive për shmangien e shkeljes përmes përshpejtimin të procedurave, atëherë ato i lënë vend aplikimit të mjeteve riparuese kompensuese të kësaj vonese.

27. Nga ana tjetër, Gjykata çmon të evidentojë se mjetet e reja juridike që parashikon legjislativori në dispozicion të individit janë testuar në lidhje me efektivitetin e tyre në një situatë jo të zakonshme të funksionimit të sistemit gjyqësor dhe zhvillimit të procedurave gjyqësore. Për këtë arsye, është e nevojshme që edhe vetë individit të tregojë kujdesin e duhur, në kohën e duhur. Kjo do të thotë se individit, përpara se të kërkojë shpërblimin e dëmit, duhet të përdorë në kohën e duhur mjetin juridik parandalues/përshpejtues (kupto kërkesën për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave). Një qasje e tillë përputhet me qëllimin e mjeteve juridike të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së, si dhe me parimin e subsidiaritetit, sipas të cilit, Gjykata ndërhyr në ato raste kur gjykatat e zakonshme nuk kanë qenë në gjendje të riparojnë shkeljet e së drejtës për proces të rregullt.

28. Gjykata vlerëson të theksojë, gjithashtu, se GJEDNJ-ja arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit e ka analizuar në tërësinë e tij, duke theksuar se praktika e “fragmentarizimit të procedurave” e zbatuar nga gjykatat kombëtare është e papajtueshme me nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së dhe arsyeshmëria e kohëzgjatjes së tyre duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes të marrë si një e tërë (*shih Rutkowski dhe të tjerë kundër Polonisë, nr. 72287/10, 13927/11, 46187/11 dhe 591 aplikime të tjera, datë 7.7.2015, §§ 212–213*). Duke iu referuar edhe mjeteve të reja juridike, të miratuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi, ajo gjykatë ka vlerësuar se në vlerësim të pajtueshmërisë me kërkesën për “afat të arsyeshëm”, gjykatat e brendshme duhet të kenë në konsideratë të gjithë kohëzgjatjen e procedurave dhe të shqyrtojnë kohëzgjatjen e përgjithshme të të gjitha fazave të procedurave, në vend që ta kufizojnë vlerësimin e kohëzgjatjes së procedurave në atë moment që një individ bën një kërkesë në mbështetje të nenit 399/6, pika 1, të KPC-së (*shih Bara dhe Kola kundër Shqipërisë, § 108*).

29. Gjykata vëren se KPC-ja ka parashikuar jo vetëm kohëzgjatjen që konsiderohet e arsyeshme për secilën fazë dhe shkallë të procesit, por edhe të drejtën e individit palë në procedura që të përdorë mjetet parandaluese në secilën fazë dhe shkallë gjykimi, kërkesë që, në çdo rast, shqyrtohet nga një gjykatë më e lartë se gjykata në vonesë, kurse në Gjykatën e Lartë nga një kolegji tjetër i saj. Në këtë kuptim, edhe pse sipas ligjit zgjidhja përshpejtuese/parandaluese dhe kompensuese zbatohet për çdo shkallë dhe fazë të veçantë të procesit, kohëzgjatja e procesit jo vetëm që vlerësohet në lidhje me kohëzgjatjen tërësore të procedurave por, nga ana tjetër, ndikon drejtpërsëdrejti në këtë drejtim. Në vlerësimin e Gjykatës, edhe pse vlerësimi i kërkesave për shkelje të afatit të arsyeshëm, në kuptim të parashikimeve procedurale të neneve 399/1 e vijues të KPC-së, bëhet në përputhje me rrethanat konkrete të çdo çështjeje të veçantë, kohëzgjatjen tërësore të saj dhe pasojat e kësaj kohëzgjatjeje në të drejtat e kërkuarit, qëllimi parësor i këtyre mjeteve juridike është njohja e shkeljes së kërkesës për “afat të arsyeshëm”, sipas nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së dhe parandalimi i zgjatjes në mënyrë të tepruar të afatit të procesit përmes përshpejtimit të tij dhe, në eventualitet, korrigjimi i vonesave të ndodhura përmes shpërblimit të dëmit.

30. Në rast se individ i nuk i shteron mjetet juridike në momentin dhe kohën e duhur, në përputhje me mundësitë dhe të drejtat që i ofron legjislacioni i zakonshëm për korrigjimin e shkeljes së pretenduar dhe, për më tepër, nëse nuk provon se këto mjete janë joefektive, kjo nuk nënkupton se ai mund të rivendoset në të drejtën për të ngritur pretendime në Gjykatë në përfundim të të gjithë procesit gjyqësor, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, për arsyeshmërinë e kohëzgjatjes tërësore të procesit.

31. Për sa më sipër, kërkuarja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000.

32. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkuarja nuk legjitimohet për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 28.2.2024.

Shpallur më 26.3.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Ilir Toska, Genti Ibrahimi

Anëtar kundër: Marjana Semini

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 8 (L) 2023 të Regjistrisë Themeltar, me kërkuese Ledina Mandija, me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 32/1, datë 19.1.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë, nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, sepse në vlerësimin tim kërkuësja legjitimohej t'i drejtohej kësaj Gjykate, pasi ka plotësuar të gjitha kriteret e legjitimitit, përfshirë atë të shterimit të mjeteve juridike efektive.

2. Sipas shumicës, gjatë kohës që çështja e kërkueses ndodhej në gjykatën e apelit, edhe pse kishte në dispozicion dy mjete juridike, ajo nuk rezultoi të ketë treguar kujdesin e duhur për ndërmarrjen e atyre hapave procedurale që i njihje legjislativi në fuqi për të siguruar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit ose edhe përshpejtimin e procedurave. Paraqitja e një ankimi kushtetues në Gjykatë, pavarësisht natyrës deklarative të vendimit që konstatonte cenimin, edhe pse mund të mos kishte pasoja në drejtim të përshpejtimit të gjykimit të zakonshëm, do të kishte pasjellë për kërkuesen lindjen e së drejtës për të kërkuar shpërblimin e dëmit në gjykatat e zakonshme për shkak të vonësës qoftë në bazë të dispozitave materiale civile, qoftë në bazë të dispozitave të reja procedurale që hynë në fuqi në atë kohë (*shih paragrafin 23 të vendimit*). Për sa i përket kërkesës në Gjykatën e Lartë, sipas shumicës, ajo qartazi ka qenë formale dhe as vetë kërkuësja nuk duket se ka pasur ndonjë pritshmëri në drejtim të efektivitetit të saj lidhur me përshpejtimin e procesit, zhvillimi i të cilit tashmë ishte planifikuar duke u caktuar edhe data e shqyrtimit të rekursit, ndaj ajo nuk mund të konsiderohet e mjaftueshme në kuptim të shterimit të mjeteve juridike përpara vënies në lëvizje të gjykimit kushtetues (*shih paragrafin 24 të vendimit*).

3. Në çështjen konkrete në shqyrtim, ashtu siç konstaton edhe shumica, në kohën që çështja e kërkueses ishte në shqyrtim në gjykatën e apelit administrativ, Gjykata kishte pranuar juridiksionin e saj për shqyrtimin e kërkesave për gjykim tej afatit të arsyeshëm, jo vetëm kur çështja ishte ende në fazën e gjykimit, por edhe kur procesi gjyqësor kishte përfunduar në të gjitha shkallët e gjykimit në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke vlerësuar në këtë rast kohëzgjatjen tërësore të procedurave gjyqësore. Megjithatë, këto lloj vendimesh, edhe nëse vendosnin pranimin e kërkesës dhe konstatimin e cenimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, kishin natyrë deklarative dhe jo vetëm që nuk ishin efektive në drejtim të përshpejtimit të procesit, por nuk është provuar të kishin efekt as në drejtim të shpërblimit të dëmit në përputhje me parashikimet e Kodit Civil. Po gjatë kohës që çështja ishte në pritje të gjykimit në gjykatën e apelit u miratuan dhe hynë në fuqi (më 05.11.2017) dispozitat e reja procedurale (nenet 399/1 e vijues të KPC-së) që përcaktuan mjetet juridike në dispozicion të individit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e drejtë, kur konstatohet kohëzgjatja e paarsyeshme në procedurat e hetimit, gjykimit të çështjeve, si edhe në procedurat e ekzekutimit të vendimeve. Megjithatë, edhe paraqitja e një kërke në kuptim të këtyre dispozitave nuk është provuar nga shumica se do të ishte e suksesshme për kërkuesen, për shkak të kohës së pamjaftueshme për shqyrtimin e saj nga gjykata kompetente.

4. Për sa i përket Gjykatës së Lartë, çështja e kërkueses (rekursi) është regjistruar në atë gjykatë në datën 12.3.2018 dhe vetëm në datën 25.11.2022, kërkuësja ka paraqitur përpara asaj gjykate kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për shkak të kohëzgjatjes së procesit si në gjykatën e apelit, ashtu edhe në Gjykatën e Lartë, pra pasi kërkuësja është njohur me datën e seancës gjyqësore.

5. Sipas GJEDNJ-së, neni 13 i KEDNJ-së është një mjet efektiv nëse ai mund të përdoret ose për të përshpejtuar dhënien e vendimit nga gjykata që shqyrton çështjen, ose për t'i siguruar palës korrigjimin për vonesat që kanë ndodhur tashmë (*shih Sürmeli kundër Gjermanisë [DhM], 2006, § 99*). Po sipas GJEDNJ-së, ndërsa mjeti parandalues është i preferueshëm, një mjet kompensues mund të konsiderohet si efektiv kur procedurat tashmë kanë qenë tepër të gjata dhe nuk ka asnjë mjet parandalues të disponueshëm (*shih Kudla kundër Polonisë [DhM], 2000, § 158; Scordino kundër Italisë (nr. 1) [DhM]*). Për sa i përket përshtatshmërisë dhe mjaftueshmërisë së një kompensimi të tillë, ky përfundim zbatohet vetëm me kushtin që një kërkesë për kompensim të mbetet në vetvete një mjet juridik efektiv, i përshtatshëm dhe i aksesueshëm në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave gjyqësore (*shih Mifsud kundër Francës [DhM], 2002, § 17*). Në lidhje me mjetin e parashikuar nga legjislacioni shqiptar, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se zgjidhja për përshpejtimin e procedurave dhe ofrimin e kompensimit është efikase, pasi mund të parandalojë vijimësinë e shkeljes së pretenduar të së drejtës së individit që çështja e tij të dëgjohet pa vonesa të tepërta, si dhe të garantojë korrigjimin e duhur për shkeljet që kanë ndodhur (*shih Bara dhe Kola kundër Shqipërisë, § 119*).

6. Sipas shumicës, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se praktika e “fragmentarizimit të procedurave” e zbatuar nga gjykatat kombëtare është e papajtueshme me nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së dhe arsyeshmëria e kohëzgjatjes së tyre duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes së marrë si një e tërë. Në vlerësim të pajtueshmërisë me kërkesën për “afat të arsyeshëm”, gjykatat e brendshme duhet të kenë në konsideratë të gjithë kohëzgjatjen e procedurave dhe të shqyrtojnë kohëzgjatjen e përgjithshme të të gjitha fazave të procedurave në vend që ta kufizojnë vlerësimin e kohëzgjatjes së procedurave në atë pikë që një individ bën një kërkesë në mbështetje të nenit 399/6, pika 1, të KPC-së (*shih paragrafin 28 të vendimit*).

7. Për sa më sipër, edhe pse kërkesja në kohën që ka paraqitur kërkesën në Gjykatën e Lartë nuk ka pasur ndonjë pritshmëri në drejtim të asaj faze konkrete në të cilën ndodhej procesi gjyqësor, në të vërtetë ajo ka synuar përshpejtimin e procedurave në aspektin tërësor të tyre, për sa kohë që objekt i rekursit ishte një vendim i gjykatës së apelit që kishte kthyer çështjen e saj për rigjykim në shkallë të parë. Objekt i ankimit kushtetues individual të paraqitur nga kërkesja është konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt për shkak të tejkalimit të çdo afati të arsyeshëm të gjyqësorisë së çështjes së kërkesës, e cila ende sot, pas rreth 10 vjetësh, duke iu referuar momentit të paraqitjes së padisë në gjykatën administrative të shkallës së parë, është në pritje që çështja e saj të shqyrtohet nga ajo gjykatë dhe nuk rezulton ndonjë perspektivë për kohën se kur ajo do të ketë një përgjigje përfundimtare në lidhje me të drejtën e saj që kërkon të mbrojë përmes gjyqësorisë të zakonshme. Kërkesja ka ngritur pretendime si në lidhje me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë për shqyrtimin e rekursit, ashtu edhe në lidhje me procesin e zhvilluar në gjykatën e apelit dhe kohëzgjatjen tërësore të procedurave.

8. Në analizë të nenit 399/1 të KPC-së që parashikon se në kompetencë të gjykatave hyn edhe shqyrtimi i kërkesave për shpërblimin e drejtë të personit që ka pësuar një dëm, për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes, sipas nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së, çmohet se qëllimi i ligjvënësive është që, në çdo rast që konstatohet se ka një kohëzgjatje të paarsyeshme, të ketë dëmshpërblim të drejtë (si në secilën nga fazat e gjyqësorisë, ashtu edhe në drejtim të të gjithë procesit civil në tërësi). Kjo është arsyeja që vetë dispozita në fjalë parashikon që gjykatat përcaktojnë vlerësimin e kohëzgjatjes së arsyeshme, si dhe shpërblimin e drejtë, që nga procedurat e hetimit, të gjyqësorisë së çështjeve dhe deri në ekzekutimin e vendimeve. Në rastin konkret, objekti i kërkesës për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt për shkak të tejkalimit të çdo afati të arsyeshëm përfshin: i. konstatimin e faktit të kohëzgjatjes së paarsyeshme; dhe ii. kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga kjo tejzgjatje e paarsyeshme.

9. Për rrjedhojë të analizës së mësipërme, vlerësoj se kompensimi i dëmeve të shkaktuara nga kohëzgjatja nuk është automatikisht i lidhur vetëm me parandalimin e vonesës ose përshpejtimin e gjyqësorisë. Në ndryshim nga shumica që vlerëson se këto mjete juridike janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën në mënyrë subsidiare, (*shih paragrafin 26 të vendimit*), i qëndroj mendimin tim të shprehur

edhe në çështjen me nr. 13 (A) 2022 të Regjistrisë Themeltar me kërkuar Agron Bajri (*mendimi i pakicës*), ku parashtrihet se mjetet e mësipërme juridike janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën në atë mënyrë, që në rast se mjetet parandaluese nuk kanë qenë efektive, ato i lënë vend aplikimit të mjeteve korrigjuese të kësaj vonese. Për sa më lart, vlerësoj se në analizën e natyrës së mjeteve të parashikuara nga ligjvënësi, kompensimi për dëmshpërblimin e drejtë është një mjet efektiv, i cili mund të përdoret: i. si në mënyrë kumulative i shoqëruar me funksionin e përsheptimit ose parandalimit të tejzgjatjes së paarsyeshme; ii. ashtu edhe si mjet i mëvetshëm kur kërkuar e ka humbur interesin për përdorimin e përsheptimit/parandalimit si mjet, por synon vetëm konstatimin e vonesës, për shkak se tejzgjatja është aq e tejkaluar në kohë, sa parandalimi nuk ka më asnjë vlerë përdorimi. Fakti që Gjykata e Lartë ka shpallur një datë për gjykimin e çështjes së themelit në dhomën e këshillimit në datën 1.12.2022, ndërkohë që kërkuarja ka bërë kërkesë për konstatimin e shkeljes së procesit të rregullt nga Gjykata Administrative e Apelit dhe nga Gjykata e Lartë në datën 25.11.2022 (pra, nëntë ditë më vonë), ka bërë që Gjykata e Lartë në gjykimin e datës 19.1.2023, të vendosë pushimin e gjykimit, sepse ka vlerësuar se çështja ka mbetur pa objekt. Në vlerësimin tim, analizimi i fakteve të tilla në referencë tepër të ngushtë të datave dhe ditëve, duke harruar që bëhet fjalë për një proces në tërësi që ka mbi 10 vjet që vijon dhe, për më tepër, një proces që është ende në gjykim (se është kthyer për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë), e bën mjetin e konstatimit të shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe kompensimin e drejtë, joefektiv. Nëse do të ecet me këtë logjikë, në konkluzion i bie që dispozita (*neni 399/1 i KPC-së*) të mos përdoret pothuajse fare, duke e bërë tejzgjatjen e paarsyeshme *quasi* të pakompensueshme në asnjë rast.

10. Në kuptim të sa më sipër, shumica nuk ka vlerësuar, (duke pasur parasysh edhe praktikën e Gjykatës së Lartë), pasojat që do të kishte pasur paraqitja e kërkesës në një kohë më të hershme në drejtim të kohëzgjatjes së procedurave në tërësi ose në drejtim të përsheptimit të tyre, ose në drejtim të parandalimit që ato të marrin një kohë paarsyeshmërisht të gjatë. Kjo, duke pasur parasysh se zgjidhja parandaluese në Gjykatën e Lartë nuk rezulton të ketë prodhuar rezultate *de facto*, por vetëm *de jure*. Në praktikën e kësaj Gjykate jo rrallëherë është konstatuar qasja e Gjykatës së Lartë në drejtim të shqyrtimit të këtyre kërkesave, për sa kohë ajo gjykatë ndalet në vlerësimin e të tilla kërkesave vetëm duke referuar efektet e reformës në drejtësi, por pa analizuar asnjë nga elementet që përcaktojnë kohëzgjatjen e arsyeshme (*shih vendimin nr. 46, datë 3.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe pse Gjykata e Lartë ka detyrimin dhe kompetencën si gjykatë e ligjit të interpretojë dispozitat e reja procedurale në drejtim të pasojave të tyre në të drejtat e individit, ajo nuk e ka bërë një gjë të tillë, duke i shndërruar këto mjete joefektive në praktikë, për sa kohë që ato jo vetëm që nuk arrijnë të përsheptojnë procesin ose parandalojnë shkeljen, por as të sigurojnë korrigjimin e saj dhe garantimin e shpërblimit të drejtë atëherë kur përsheptimi nuk është i mundur.

11. Në kuptim të sa më sipër, në vlerësimin tim, në rastin konkret, kërkuarja i ka shteruar formalisht mjetet juridike përpara vënies në lëvizje të gjykimit kushtetues, por edhe në substancë, për sa kohë që nuk provohet në këtë rast efikasiteti i kërkesës në drejtim të kohëzgjatjes tërësore të procedurave ku ajo është palë. Për sa kohë që kriteri i shterimit të mjeteve është plotësuar në rastin konkret, shumica duhej të kishte shqyrtuar në themel çështjen dhe duhej të kishte vlerësuar nëse në rastin konkret është shkelur e drejta e kërkuarës për gjykimin e çështjes së saj brenda një afati të arsyeshëm.

12. Në lidhje me themelin e çështjes, referuar rrethanave të çështjes konkrete, pra kohëzgjatjes së procesit gjyqësor në tërësinë e tij, rezulton se ai ka filluar në gjykatën e shkallës së parë në vitin 2014 dhe në vitin 2017 çështja është kthyer për rigjykim nga gjykata e apelit sërish në shkallë të parë. Në Gjykatën e Lartë çështja është regjistruar në datën 12.3.2018 dhe ka përfunduar në datën 22.12.2022, kur është dhënë vendimi i Kolegjit Administrativ për shqyrtimin e rekursit. Pas këtij vendimi pritet që tashmë çështja e kërkuarës të shqyrtohet në gjykatën e shkallës së parë, e cila do të shprehet në lidhje me thelbin e kërkesëpadisë së paraqitur prej saj. Për rrjedhojë, kohëzgjatja e procesit gjyqësor të vënë në lëvizje nga kërkuarja është rreth 10 vjet, ndërkohë që ajo ende nuk ka një vendim përfundimtar në lidhje me thelbin e pretendimeve të saj.

13. Duke iu referuar kriterëve që kihen parasysh në vlerësimin e arsyeshmërisë së kësaj kohëzgjatjeje, rezulton se, për sa i përket sjelljes së kërkueses, ajo është pala që ka vënë në lëvizje gjykatat e zakonshme, ka vepruar në përputhje me të drejtat e saj procedurale dhe në ushtrim të mjeteve juridike që i njeh legjislacioni në fuqi me qëllim mbrojtjen e të drejtave ligjore të pretenduara të cenuara, por nuk rezulton të kenë shkaktuar vonesa ose të jenë bërë shkak për vonesat në procedura. Në lidhje me kompleksitetin e çështjes, nga aktet e saj nuk konstatohet që ajo të shfaqë ndonjë kompleksitet që të justifikojë kohëzgjatjen e saj. Kurse në lidhje me sjelljen e autoriteteve, nga Gjykata e Lartë, edhe pse çështja e saj përfshihet në të dyja këto kategori që kërkojnë shqyrtimin e rekursit me përparësi, nuk rezulton që ajo të ketë marrë ndonjë masë ose të ketë vepruar në përputhje me radhën e përparësisë së shqyrtimit të këtyre lloj çështjesh dhe nuk ka qenë në nivelin e duhur të efikasitetit që kërkon e drejta për proces të rregullt. Në lidhje me interesin e kërkueses, referuar natyrës së çështjes, konsiderohet se ajo ka interes të tillë, për sa kohë çështja lidhet me interesa “vetjakë e jetësorë” të saj, për rrjedhojë kohëzgjatja e procedurave gjyqësore në rastin konkret ka rëndësi në drejtim të asaj që rrezikon si palë në procesin gjyqësor.

14. Në përfundim, për sa më sipër, vlerësoj se kërkesa ishte e bazuar edhe në themel, për rrjedhojë, duhej të ishte vendosur pranimi i saj, duke u konstatuar cenimi i së drejtës për proces të rregullt në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor dhe e drejta për kompensimin e shpërblimit të drejtë për kërkuesen Ledina Mandija.

Anëtare: Marjana Semini